

V E N D I M

“PER REGJISTRIMIN E SHOQERISE SI PERSON JURIDIK”

Sot, me date 30/11/2006 ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, une Gjyqtari M. Luma i kesaj Gjykate pasi u njoha me materialin e paraqitur nga Isuf Berberi per te regjistruar shoqerine si person juridik :

KONSTATOVA SE:

Shoqerite “FASSA INTERNATIONAL” S.A., nepermjet vendimit te Bordit date 16/10/2006, dhe “OTTO-AL” Sh.p.k., nepermjet vendimit te Ortakut te Vetem date 17/11/2006, ne cilesine e aksionereve vendosen krijimin e shoqerise anonime “FASSA & BERBERI” Sh.a., duke hartuar dhe nenshkruar per kete qellim Statutin dhe Aktin e Themelimit te shoqerise sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Aksioneret e shoqerise jane:

1. “FASSA INTERNATIONAL” S.A., e krijuar ne baze te ligjeve te Luksemburgut, me seli ne adresen 3A, rue G. Kroll a L – 1882, Luxembourg, me numer regjistri No. B 86030 ne Regjistrin Tregtar te Luksemburgut, perfaqesuar nga Z. Paolo Fassa.
2. “OTTO-AL” Sh.p.k., e krijuar ne baze te ligjeve te Shqiperise me vendimin e Gjykates Nr. 21020, date 12/03/1999, me seli ne adresen Rruga e Elbasanit, pallati prane Fakultetit te Gjeologji Minierave, Tirane, perfaqesuar nga Z. Isuf Berberi.

Kapitali themeltar i Shoqerise Anonime “FASSA & BERBERI” Sh.a. eshte 20,000,000.00 (njezet milion) Lek, i ndare ne 1,000 (njemije) aksione me nje vlere nominale prej 20,000 (njezetmije) Lek secili, te numeruara me numer serie nga 1 deri ne 1,000, dhe zoterohet nga Aksioneret si me poshte vijon:

Aksioneri “FASSA INTERNATIONAL” S.A. ka kontribuar ne kapitalin themeltar me vleren prej Lek 14,800,000.00 (katembedhjte milion e teteqindmije) duke i koresponduar 74% (shtatedhjte e kater) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Aksioneri “OTTO-AL” Sh.p.k. ka kontribuar ne kapitalin themeltar me vleren prej Lek 5,200,000.00 (pesemilion e dyqindmije) duke i koresponduar 26% (njezet e gjashte) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Objekt i veprimtarise do te jete:

- Veprimtari te ndryshme tregtare, import – eksport;
- Veprimtari te ndryshme prodhuese vecanerisht te perqendruara ne prodhimin e materialeve te ndertimi;
- Veprimtari ne fushen e ndertimit kryesisht e perqendruar ne sektorin e sherbimeve energjitike, hidro, te ndertimit dhe shfrytezimit te minierave, etj.
- Veprimtari te tjera te lejuara nga legjislacioni Shqiptar.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin e shoqerive tregtare. Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Aksionereve qe zoterojne $\frac{1}{4}$ e kapitalit themeltar ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane, ne adresen, Rruga e Elbasanit, pallati prane fakultetit Gjeologji dhe Miniera. Shoqeria mund te krijojë filiale, dege dhe perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise sipas nevojave te saj me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane:

Z. Paolo Fassa, Kryetar

Z. Doni Berberi, Nenkryetar

Z. Bortolo Fassa, Anetar

Drejtor i Pergjithshem i shoqerise per periudhen e pare prej pese vjetesh eshte Z. Isuf Berberi, i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblese se Aksionereve.

Eksperti i pare kontabel i autorizuar i shoqerise anonime “FASSA & BERBERI” eshte Z. Qani Kajo.

Per sa me siper gjykoj se kerkesa e Z. Berberi eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare” dhe te Ligjit 7667, date 28.01.1993 “Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare”.

VENDOSA:

- I. Pranimin e kerkeses se Z. Isuf Berberi dhe regjistrimin si person juridik te Shoqerise “FASSA & BERBERI” Sh.a. te themeluar nga Aksioneret:

- “FASSA INTERNATIONAL” S.A., e krijuar ne baze te ligjeve te Luksemburgut, me seli ne adresen 3A, rue G. Kroll a L – 1882, Luxembourg, me numer regjistri No. B 86030 ne Regjistrin Tregtar te Luksemburgut, perfaqesuar nga Z. Paolo Fassa.
- “OTTO-AL” Sh.p.k., e krijuar ne baze te ligjeve te Shqiperise me vendimin e Gjykates Nr. 21020, date 12/03/1999, me seli ne adresen Rruga e Elbasanit, pallati prane Fakultetit te Gjeologji Minierave, Tirane, perfaqesuar nga Z. Isuf Berberi.

Kapitali themeltar i Shoqerise Anonime “FASSA & BERBERI” Sh.a. eshte 20,000,000.00 (njezet milion) Lek, i ndare ne 1,000 (njemije) aksione me nje vlere nominale prej 20,000 (njezetmije) Lek secili, te numeruara me numer serie nga 1 deri ne 1,000, dhe zoterohet nga Aksioneret si me poshte vijon:

Aksioneri “FASSA INTERNATIONAL” S.A. ka kontribuar ne kapitalin themeltar me vleren prej Lek 14,800,000.00 (katemmbedhjete milion e teteqindmije) duke i koresponduar 74% (shtatedhjete e kater) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Aksioneri “OTTO-AL” Sh.p.k. ka kontribuar ne kapitalin themeltar me vleren prej Lek 5,200,000.00 (pesemilion e dyqindmije) duke i koresponduar 26% (njezet e gjashte) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Objekt i veprimtarise do te jete:

- Veprimtari te ndryshme tregtare, import – eksport;
- Veprimtari te ndryshme prodhuese vecanerisht te perqendruara ne prodhimin e materialeve te ndertimi;
- Veprimtari ne fushen e ndertimit kryesisht e perqendruar ne sektorin e sherbimeve energjitike, hidro, te ndertimit dhe shfrytezimit te minierave, etj.
- Veprimtari te tjera te lejuara nga legjislacioni Shqiptar.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin e shoqerive tregtare. Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Aksionereve qe zoterojne $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane, ne adresen, Rruga e Elbasanit, pallati prane fakultetit Gjeologji dhe Miniera. Shoqeria mund te krijojte filiale, dege dhe perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise sipas nevojave te saj me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane:

Z. Paolo Fassa, Kryetar

Z. Doni Berberi, Nenkryetar

Z. Bortolo Fassa, Anetar


Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën e parë prej pesë vjetësh është Z. Isuf Berberi, i cili do të ushtrojë të gjitha kompetencat për administrimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë, për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblesë së Aksionerëve.

Eksperti i parë kontabel i autorizuar i shoqërisë anonime "FASSA & BERBERI" është Z. Qani Kajo.

2. Regjistrimin e kësaj shoqërie si person juridik dhe urdherimin e zyrës së Regjistrimit Tregtar për kryerjen e veprimeve përkatëse.

Kundra këtij vendimi lejohet ankim.

GJYQTAR

A handwritten signature in black ink, appearing to be "Naim Isufi", written over a horizontal line.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Rrethit Tirane

Nr. Prot. *21.020*

VERTETOHET NJESIA
ORIGINALIN E
SEKRETARAT
TREGTAR

PULLE TAKSE



VENDIM

PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me date *12.02.1999*, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi morrane shqyrtim kerkesen e kerkuesve, Isuf BERBERI dhe Stephan OTTO te cilet kerkojne te rregjistrojne si person juridik shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "OTTO - AL" sh.p.k.;

KONSTATOVA

Se kerkuesit kerkojne te rregjistrojne si person juridik shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "OTTO - AL" sh.p.k., me Ortake dhe Administratore, Isuf BERBERI dhe Stephan OTTO me kohezgjatje mbi 10 (dhjete) vjet me kapital themeltar te shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "OTTO - AL" sh.p.k., eshte 100.000 (njeqind mije) leke, e ndare ne pjese (kuota) me vlere 1000(njemije) leke seicila, plotesisht te shlyera. Kapitali themeltar eshte i ndare si me poshte:

- Stephan OTTO si Ortak ne shoqeri, kontribuon me kapitalin 55.000 (pesedhjete e pese mije) leke, e barabarte me kuoten e pjesmarrjes ne shoqeri 55%.(pesedhjete e pese per qind).
- Isuf BERBERI si Ortak ne shoqeri kontribuon ne shoqeri me kapitalin 45.000 (dyzet e pese mije) leke, e barabarte me kuoten e pjesmarrjes ne shoqeri 45% (dyzet e pese per qind)

Shtimi i kontributeve te Ortakeve ne para apo ne natyre nuk eshte i kufizuar.

Me seli ne Tirane, Rr. e Elbasanit Pall. 1 Shk. 11 dhe me objekt veprimtarie:

Konsulence, Projektim, Ndertime dhe Supervizione ne fushen e ndertimit si me poshte;

- Punime dheu, sistemime, taracime terrenesh etj.
- Prodhim materialesh ndertimi, si inerte, rere, çakell, gure, mermere, etj., qeramika, elemente parafabrikat, elemente te paranderur, materiale lidhes, si çimento, allçi etj., prodhim materiale bituminoze, prodhim materiale druri, metalike, plastike, per dyer dritare etj.
- Ndertime civile dhe ekonomike.
- Ndertime rrugore te te gjitha kategorive perfshire dhe ato speciale (autostrada, superstrada etj.)
- Ndertime pistash dhe aeroportesh.
- Ndertime veshjesh asfaltike e shtresash rrugore.

- Punime rikonstruksioni, mirembajtjeje, sinjalizimi dhe vijeziimi ne rruge.
- Nderitime te veprave te artit rrugor dhe hekurudhore te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (ura, viadukte,, tunele etj.).
- Nderitime hidroteknike, ujesjellesa dhe kanalizime, vepra kullimi, ujitjeje, punime mbrojtjeje dhe sistemime etj.
- Nderitime te veprave te vecanta dhe speciale ulla, sillose etj., b/a, themele te vecanta dhe punime mbrojtjeje te themelit etj.
- Punime restaurimi, rikonstruksione, godinash civile dhe ekonomike etj.
- Punime karpentierie, druri dhe metalike.
- Punime sherbimi te zakonshem te sistemit komunal dhe punime mirembajtjeje
- Punime topogjeodezike, gjeologjike dhe analizash laboratorike per punimet rugore.
- Ne fushen e import-eksporteve, transportimin e mallrave brenda dhe jashte vendit pika servisi, pjese kembimi per makina dhe automjete.

Kerkesa e tyre eshte plotesisht e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit 7638, date 19/11/1992 per shoqerite tregtare si dhe ligjit 7677 date 28/01/1993 per rregjistrimin tregetar;

VENDOSA:

Te rregjistroj si person juridik shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "OTTO - AL" sh.p.k. me Ortake dhe Administratore, Isuf BERBERI dhe Stephan OTTO me kohezgjatje mbi 10 (dhjete) vjet me kapital themeltar te shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "OTTO - AL" sh.p.k., eshte 100.000 (njqind mije) leke, e ndare ne pjese (kuota) me vlere 1000(njemije) leke seicila, plotesisht te shlyera. Kapitali themeltar eshte i ndare si me poshte:

- Stephan OTTO si Ortak ne shoqeri, kontribuon me kapitalin 55.000 (pesedhjete e pese mije) leke, e barabarte me kuoten e pjesmarrjes ne shoqeri 55%.(pesedhjete e pese per qind).
- Isuf BERBERI si Ortak ne shoqeri kontribuon ne shoqeri me kapitalin 45.000 (dyzet e pese mije) leke, e barabarte me kuoten e pjesmarrjes ne shoqeri 45% (dyzet e pese per qind)

Shtimi i kontributeve te Ortakeve ne para apo ne natyre nuk eshte i kufizuar.
Me seli ne Tirane, Rr. e Elbasanit Pall. 1 Shk. 11 dhe me objekt veprimtarie:

Konsulence, Projektim, Nderitime dhe Supervizione ne fushen e ndertimit si me poshte;

- Punime dheu, sistemime, taracime terrenesh etj.
- Prodhim materialesh ndertimi, si inerte, rere, çakell, gure, mermere, etj., qeramika, elemente parafabrikat, elemente te paranderur, materiale lidhes, si çimento, allçi etj., prodhim materiale bituminoze, prodhim materiale druri, metalike, plastike, per dyer dritare etj.

- Nderime civile dhe ekonomike.
- Nderime rrugore te te gjitha kategorive perfshire dhe ato speciale (autostrada, superstrada etj.)
- Nderime pistash dhe aeroportesh.
- Nderime veshjesh asfaltike e shtresash rrugore.
- Punime rikonstruksioni, mirembajtjeje, sinjalizimi dhe vijezi ne rruge.
- Nderime te veprave te artit rrugor dhe hekurudhore te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (ura, viadukte,, tunele etj.).
- Nderime hidroteknike, ujesjellesa dhe kanalizime, vepra kullimi, ujitjeje, punime mbrojtjeje dhe sistemime etj.
- Nderime te veprave te vecanta dhe speciale ulla, sillose etj., b/a, themele te vecanta dhe punime mbrojtjeje te themelit etj.
- Punime restaurimi, rikonstruksione, godinash civile dhe ekonomike etj.
- Punime karpentierie, druri dhe metalike.
- Punime sherbimi te zakonshem te sistemit komunal dhe punime mirembajtjeje
- Punime topogjeodezike, gjeologjike dhe analizash laboratorike per punimet rrugore.
- Ne fushen e import-eksporteve, transportimin e mallrave brenda dhe jashte vendit pika servisi, pjese kembimi per makina dhe automjete.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQTAR

Shirina Cof

Cy

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 21020/1
6935

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Tirane, me 07 8.1999

Une, Imirco Celo, gjyqtare ne Gjykatën e Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Z. Isuf Berberi, administrator i Shoqerise Tregtare **OTTO – AL” Shpk**, regjistruar ne regjistrin tregtar ne baze te vendimit Nr.21020, date 12.3.1999.te Gjykates se Rrethit Tirane per depozitim ne regjistrin tregtar te dy vendimeve te asamblese se ortakëve date 5.8.1999, dhe dy te kontrates se shitjes se kuotave te dates 5.8.1999 dhe:

KONSTATOVA

Shoqeria Tregtare **OTTO – AL” Shpk** eshte regjistruar ne regjistrin tregtar ne baze te vendimit Nr.21020, date 12.3.1999.te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me vendimin Nr.1 dates 5.8.1999, asambleja e ortakëve, e shoqerise tregtare **OTTO – AL” Shpk** vendosit qe ortakët te transferoje nepermjet shitjes tek shoqeria tregtare **ALKO-IMPEX Shpk** perfaqesuar nga administratori i saj Z.Imer Ademi kuota te tyre ne kapitalin themeltar respektivisht:

Shoqerise tregtare **“OTO TIEFBAU GmbH & Co.**, te transferojë 36 kuota ose 36% te kapitalit themeltar, ne shumen 36 000 leke duke mbajtur per vehte 19 kuota.

Z.Isuf Berberi te transferojë 4 kuota ose 4% te kapitalit themeltar, ne shumen 4000 leke duke mbajtur per vehte 41 kuota.

Me kontraten e shitjes date 5.8.1999, ortakët **“OTTO TIEFBAU GmbH & Co.**, perfaqesuar nga Stephan Otto, i transferoi nepermjet shitjes, shoqerise tregtare **“ALKO-IMPEX” Shpk**, perfaqesuar nga Z.Imer Ademi, 36 kuota te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare **“OTTO-AL”**, qe perbejne 36 % te kapitalit te kesaj shoqerie me vlere 36 000 leke.

Me kontraten e shitjes date 5.8.1999, ortakët Isuf Berberi, i transferoi nepermjet shitjes, shoqerise tregtare **“ALKO-IMPEX” Shpk**, perfaqesuar nga Z.Imer Ademi 4 kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare **“OTTO-AL”**, qe perbejne 4 % te kapitalit te kesaj shoqerie me vlere 4 000 leke.

Me vendimin Nr 2 date 5.8.1999 te asamblese se ortakëve e shoqerise tregtare **OTTO – AL”**

Shpk vendosi te ndryshoje nenin (14) te statutit te Shoqerise duke caktuar si administratore te shoqerise Z.Isuf Berberi dhe Z.Imer Ademi

Ne baze te nenit 33 te ligjit Nr 7667, date 28.1.1993, kerkesa çmohet e drejte, e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar. per kete aresye:

VENDOSA

Pranimin e kerkeses se paraqitur nga Z.Isuf Berberi.

Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimin Nr.1 dates 5.8.1999, te asamblese se ortakeve, te shoqerise tregtare **OTTO – AL” Shpk** e cila vendosi qe ortakët te transferoje nepermjet shitjes tek shoqeria tregtare **ALKO-IMPEX Shpk** perfaqesuar nga administratori i saj Z.Imer Ademi kuota e tyre ne kapitalin themeltar respektivisht::

Shoqerise tregtare **“OTTO TIEFBAU GmbH & Co.**, te transferojë 36 kuota ose 36% te vleres se kapitalit themeltar, ne shumen 36 000 leke duke mbajtur per vehte 19 kuota.
Z.Isuf Berberi te transferojë 4 kuota ose 4% te vleres se kapitalit themeltar, ne shumen 4000 leke duke mbajtur per vehte 41 kuota.

Depozitimin e kontraten se shitjes date 5.8.1999, nepermjet se ciles ortaku **“OTTO TIEFBAU GmbH & Co** perfaqesuar nga Stephan Otto, i transferoi nepermjet shitjes, shoqerise tregtare **“ALKO-IMPEX” Shpk**, perfaqesuar nga Z.Imer Ademi 36 kuota te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare **“OTTO-AL”**, qe perbejne 36 % te kapitalit te kesaj shoqerie me vlere 36 000 leke.

Depozitimin e kontrates se shitjes date 5.8.1999, nepermjet se ciles ortaku Isuf Berberi, i transferoi nepermjet shitjes, shoqerise tregtare **“ALKO-IMPEX” Shpk**, perfaqesuar nga Z.Imer Ademi 4 kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare **“OTTO-AL”**, qe perbejne 4 % te kapitalit te kesaj shoqerie me vlere 4 000 leke.

Depozitimin e vendimin Nr.2 date 5.8.1999 te asamblese se ortakeve e shoqerise tregtare **OTTO – AL” Shpk** e cila vendosi te ndryshoje nenin (14) te statutit te Shoqerise duke caktuar si administratore te shoqerise **Z.Isuf Berberi dhe Z.Imer Ademi**

Urdherimin e zyres se regjistrat tregtar te beje ndryshimet ne kolonen 4 e 5, germa

C

Ndarjen me vize te kuqe te ndryshimeve perkatese.

GJYQTARE

Smila Capi
Q

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 21020/2

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Tirane, me 51.21.2001

Une, R. Pajzesh, gjyqtare ne Gjykatën e Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi **Z.Isuf Berberi**, administrator i Shoqerise Tregtare **OTTO – AL” Shpk**, regjistruar ne regjistrin tregtar ne baze te vendimit Nr.21020, date 12.3.1999.te Gjykates se Rrethit Tirane, per depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit te asamblese se ortakëve date 22.1.2001, dhe kontrates se shitjes se kuotave te dates 26.1.2001 dhe:

KONSTATOVA

Shoqeria Tregtare **OTTO – AL” Shpk** është regjistruar ne regjistrin tregtar ne baze te vendimit Nr.21020, date 12.3.1999.te Gjykates se Rrethit Tirane.

1. Me vendimin date 22.1.2001, asambleja e ortakëve, e shoqerise tregtare **“OTTO”AL Shpk** vendosi

- Qe ortaku shoqëria tregtare **“OTO TIEFBAU GmbH & Co** perfaqesuar nga Stephan Otto, te transferojë nepermjet shitjes tek ortaku tjetër **Z.Isuf Berberi**, të tërë kuotat e saj ne kapitalin themeltar, 19 kuota, që përbejnë 19% te kapitalit të shoqërisë me vlerë 19 000 lekë.
- Qe ortaku shoqëria tregtare **ALKO-IMPEX Shpk** perfaqesuar nga administratori i saj **Z.Imer Ademi**, te transferoje nepermjet shitjes tek ortaku tjetër **Z.Isuf Berberi**, **që mbetet ortak dhe administrator i vetëm**, të tërë kuotat e saj ne kapitalin themeltar, 40 kuota, që përbejnë 40% te kapitalit të shoqërisë me vlerë 40 000 lekë
- Me kontraten e shitjes Nr. 381 Rep, 48 Kol, date 26.1.2001, të redaktuar tek notere Alida Stamo, ortaku **“OTTO TIEFBAU GmbH & Co**, perfaqesuar nga Stephan Otto, i transferoi nepermjet shitjes, ortakut Isuf Berberi, të tërë kuotat e saj ne kapitalin themeltar, 19 kuota, që përbejnë 19% te kapitalit të shoqërisë me vlerë 19 000 lekë.
- Me kontraten e shitjes Nr. 381 Rep, 48 Kol, date 26.1.2001, të redaktuar tek notere Alida Stamo, ortaku **ALKO-IMPEX Shpk** perfaqesuar nga administratori

i saj Z.Imer Ademi, i transferoi nepermjet shitjes, ortakut Isuf Berberi, të tërë kuotat e saj ne kapitalin themeltar, 40 kuota, që përbejnë 40% te kapitalit të shoqërisë me vlerë 40 000 lekë.

Ne baze te nenit 33 te ligjit Nr 7667, date 28.1.1993, kerkesa çmohet e drejte, e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar. per kete aresye:

VENDOSA

Pranimin e kerkeses se paraqitur nga Z.Isuf Berberi.

1. Depozitimn ne regjistrin tregtar te vendimin date 22.1.2001, të asamblesë së ortakëve, të shoqërise tregtare **"OTTO"AL Shpk** që vendosit :

- Qe ortakut, shoqëria tregtare **"OTO TIEFBAU GmbH & Co**, perfaqesuar nga Stephan Otto, te transferoje nepermjet shitjes tek ortakut tjetër Z.Isuf Berberi, të tërë kuotat e saj ne kapitalin themeltar, 19 kuota, që përbejnë 19% te kapitalit të shoqërisë me vlerë 19 000 lekë.

- Qe ortakut, shoqëria tregtare **ALKO-IMPEX Shpk**, perfaqesuar nga Z.Imer Ademi, te transferoje nepermjet shitjes tek ortakut tjetër **Z.Isuf Berberi, që mbetet ortak dhe administrator i vetëm**, të tërë kuotat e saj ne kapitalin themeltar, 40 kuota, që përbejnë 40% te kapitalit të shoqërisë me vlerë 40 000 lekë.

2. Depozitimn e kontrates se shitjes Nr. 381 Rep, 48 Kol, date 26.1.2001, të redaktuar tek notere Alida Stamo, nëpërmjet së cilës:

- Ortaku **"OTTO TIEFBAU GmbH & Co**, perfaqesuar nga Stephan Otto, i transferoi nepermjet shitjes, ortakut Isuf Berberi, të tërë kuotat e saj ne kapitalin themeltar, 19 kuota, që përbejnë 19% te kapitalit të shoqërisë me vlerë 19 000 lekë.

- Ortaku **ALKO-IMPEX Shpk** perfaqesuar nga administratori i saj Z.Imer Ademi, i transferoi nepermjet shitjes, ortakut Isuf Berberi, të tërë kuotat e saj ne kapitalin themeltar, 40 kuota, që përbejnë 40% te kapitalit të shoqërisë me vlerë 40 000 lekë.

Urdherimin e zyres se regjistrin tregtar te beje ndryshimet ne kolonen 4,5, germa

Ndarjen me vize te kuqe te ndryshimeve perkatese.

GJYQTARE

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 2102/3 VENDIMI

V E N D I M
“I GJYQTARIT TE VETEM “

Sot, me date 24 / 02 / 2004 ,une Gjyqtare M. Ded, prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane , pasi shqyrtova materialet e paraqitura nga kerkuesi ne emer te shoqerise “ OTTO – AL “ sh.p.k ,

K O N S T A T O V A

Se me vendimin nr 21020 date 12.03.1999 te Gjykates e Rrethit Tirane eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare e emertuar “ OTTO – AL “ sh.p.k.

Me vendimin nr 2 date 03.02.2004 te ortakut te vetem te shoqerise eshte vendosur: - zmadhimi i kapitalit te shoqerise , zmadhim ky ne natyre, miratimin e caktimit te z. Agim Binaj si ekspert per te bere vleresimet e duhura ne lidhje me kete zmadhim, si dhe depozitimin e ketij vendimi prane rregjistrit tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Per sa me lart kjo kerkese eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Bazuar ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 “ Per Shoqerite Tregetare “

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane rregjistrit tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit nr 2 date 03.02.2004 te ortakut te vetem te shoqerise “ OTTO – AL “ sh.p.k.

Te pasqyrohen ndryshimet ne kolonat perkatese te rregjistrit.

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE

Mariang Ded
M. Ded

Republika e Shqiperise
Gjykata e Shkalles Pare Tirane

Nr. 24020/4 **Vendimi**

V E N D I M

"I gjyqtarit te vetem"

Sot, me daten 26 / 4 / 2004, une gjyqtari M. Daj, prane Gjykates Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova materialet e paraqitura nga kerkuesi ne emer te shoqerise "OTTO-AL" shpk,

KONSTATOVA

Se me vendim Nr.21020 dt.12.03.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik, shoqeria tregtare e emertuar "OTTO-AL" shpk.

Me vendim Nr 21020/2, dt. 24.02.2004 te gjykates se Shkalles se Pare Tirane, eshte vendosur:

Zmadhimi i kapitalit te shoqerise, zmadhim ky ne natyre, miratimin e caktimit te Z.Agim Binaj si ekspert per te bere vleresimet e duhura ne lidhje me kete zmadhim, si dhe depozitimin e ketij vendimi prane regjistrat Tregtare te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Me vendimin Nr.3, dt. 06.03.2004 te ortakut te vetem te shoqerise "OTTO-AL" shpk, eshte miratuar akti i ekspertimit te perpiluar nga eksperti Agim Binaj ne lidhje me zmadhimin e kapitalit te shoqerise; zmadhimin e kapitalit te shoqerise "OTTO-AL" shpk ne masen 100.100.000 (njqind milionenjqindmije) leke; si dhe depozitimin e ketij vendimi prane regjistrat tregtare.

Per sa me siper kjo kerkese eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

Per keto arsye,

Bazuar ne ligjin Nr 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare",

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane regjistrat tregtare te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit Nr.3, date 06.03.2004 te ortakut te vetem te shoqerise "OTTO- AL" shpk.

Te pasqyrohen ndryshimet ne kolonat perkatese te regjistrat.

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE
M. Daj
Daj

ANEXI I

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 21020/5 Vendimit

V E N D I M

I Gjyqtarit te Vetem

Ne Tirane, sot me date 04.03.05 une gjyqtare Gjykates se Shkalles se Pare Tirane MS. J. J. J. mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Z. Isuf Berberi, ne cilesine e administratorit te Shoqerise "OTTO-AL" Sh.p.k., i cili kerkoi depozitim te akteve ne emer te shoqerise.

K o n s t a t o v a :

Se me Vendim Nr. 21020 date 12.03.1999te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare emeruar "OTTO-AL" shpk.

Me Vendim Nr. 4 date 24.02.2005 te Ortakut te Vetem te Shoqerise "OTTO-AL" shpk eshte vendosur : - Shtimi i Objektit te Veprimtarise se shoqerise "OTTO-AL" shpk I cili konsiston:

N E Z B A T I M

Te gjitha klasat dhe kategorite:

1. Germime dheu me punime eventuale murature e beton arme - prishje dhe punime ne toke te germuar.
2. Prodhim material ndertimi.
3. Ndertime civile dhe ekonomike.
4. Ndertime rrugore.
5. Punime hekurudhore.
6. Ndertim ura dhe vepra arti.
7. Ndertime detare.
8. Ndertime hidraulike e hidroteknike.
9. Vepra te vecanta e punime speciale.
10. Punime restaurimi.
11. Punime karpenterie.
12. Impiante teknologjike dhe te vecanta.
13. Punime montimi ne implantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise.

14. Punime shebimi.
15. Punime topogjeodezike.
16. Te instaloje rrejte urbane.
17. Te instaloje rrjete kablllore interurbane.
18. Te instaloje rrjete me fibra optike.
19. Te instaloje rrjete te brendeshme telekomunikacioni.
20. Te instaloje rrejte e sisteme alarmi.
21. Te instaloje sisteme telekomunikacioni.
22. Te instaloje paisje terminale telekomunikacioni.

NE PROJEKTIM

1. Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelt beton arme deri ne 5 kate.
2. Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelt beton arme deri ne 5 kate - objekte me skelet metali.
3. Linja e rrjeta elektrike - telefonike-radiofonike- citofoni- sistemalarmi- televiziv, etj per objekte civile, industriale, turistike.
4. Sisteme komplekse te telekomunikacionit.
5. Diga-galeri-tunele hidraulike.
6. Furnizim me uje - kolektore shkarkimi.
7. Projektim ujesjellels kanalizime urbane - rurale.
8. Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditese - diga deri ne 10m - damba.
9. Vepra naftesjelles- gazsjelles-vajsjelles, etj.
10. Rruge auto kategoria V dhe VI.
11. Projektim shtresa rrugore e sistem - asfalti.
12. Projektim ura dhe vepra arti deri ne 10m.
13. Projektim ura dhe vepra arti mbi 10m - Eskada.
14. Projektim impiante te prodhimit dhe shperndarje te enrgjise elektrike-dielllore-era, etj.
15. Projektim nenstacione elektrike, primare, sekondare - linja te tensionit te larte.
16. Kabina elektrike te rrejtis shperndares - linja te tensionit te ulet - te mesem.
17. Te projektoi rrjete telekomunikacioni.
18. Te projektoi sisteme telekomunikacioni.
19. Te programoje sisteme telekomunikacioni.
20. Import-Export, tregeti shumice e pakice, transport, pika servisi, pjese kembimi per makina dhe automjete.

si dhe depozitim e ketij Vendimi prane Rregjistrat Tregtar te Gjykates Shkalles Pare Tirane .

er sa me larte kjo kerkese eshte e drejte dhe duhet pranuar

Per kete arsye

Ne baze te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 dhe ligjit Nr.7638 date 19.11.1992,

V e n d o s a

Pranimin e kerkeses.

Depozitim prane Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Shkalles Pare Tirane te Vendimit Nr.4 date 24.02.2005, te Ortakut te Vetem te Shoqerise "OTTO-AL" shpk i cili ka te beje me shtimin e objektit te veprimtarise te kesaj shoqerie.

Te pasqyrohen ndryshimet ne kolonat perkatese te regjistrimit.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

Gjyqtare

[Signature]

[Handwritten notes]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 21020 / Vendimit

V E N D I M

I Gjyqtarit te Vetem

Ne Tirane, sot me date 15.09.2005 une gjyqtare Gjykates se Shkalles se Pare Tirane A. Cece mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Z. Isuf Berberi, ne cilesine e administratorit te Shoqerise "OTTO-AL" Sh.p.k., i cili kerkoi depozitimin e akteve ne emer te shoqerise.

K o n s t a t o v a:

Se me Vendim Nr. 21020 date 12.03.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare emeruar "OTTO-AL" shpk.

Me Vendim Nr. 5 date 07.04.2005 te Ortakut te Vetem te Shoqerise "OTTO-AL" shpk eshte vendosur : - Shtimi i Objektit te Veprimtarise se shoqerise "OTTO-AL" shpk i cili konsiston:

1. Projektimi, hapja dhe shfrytezimi i minierave me qellim prodhimin, perpunimin, transportimin dhe komercializimin e burimeve minerare dhe energjitike ne nentoke dhe siperfaqe, ne kufijte e parashikuar nga ligji.
2. Depozitimin e ketij Vendimi prane Rregjistrimit Tregtar te Gjykates Shkalles Pare Tirane .

Pas ketij shtimi objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

NE ZBATIM

Te gjitha klasat dhe kategorie:

1. Germime dheu me punime eventuale murature e beton arme - prishje dhe punime ne toke te germuar.
2. Prodhim material ndertimi.
3. Ndertime civile dhe ekonomike.
4. Ndertime rrugore.
5. Punime hekurudhore.
6. Ndertim ura dhe vepra arti.
7. Ndertime detare.

8. Ndertime hidraulike e hidroteknike.
9. Vepra te vecanta e punime speciale.
10. Punime restaurimi.
11. Punime karpenterie.
12. Impiante teknologjike dhe te vecanta.
13. Punime montimi ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise.
14. Punime sherbimi.
15. Punime topogjeodezike.
16. Te instaloje rrejte urbane.
17. Te instaloje rrjete kablllore interurbane.
18. Te instaloje rrjete me fibra optike.
19. Te instaloje rrjete te brendeshme telekomunikacioni.
20. Te instaloje rrejte e sisteme alarmi.
21. Te instaloje sisisteme telekominikacioni.
22. Te instaloje paisje terminale telekomunikacioni.

NE PROJEKTIM

1. Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelt beton arme deri ne 5 kate.
 2. Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelt beton arme deri ne 5 kate - objekte me skelet metali.
 3. Linja e rrjeta elektrike - telefonike- radiofonike- citofoni- sistemalarmi- televiziv, etj per objekte civile, industriale, turistike.
 4. Sisteme komplekse te telekomunikacionit.
 5. Diga-galeri-tunele hidraulike.
 6. Furnizim me uje - kolektore shkarkimi.
 7. Projektim ujesjelels kanalizime urbane - rurale.
 8. Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditese - diga deri ne 10 m - damba.
 9. Vepra naftesjelles- gazsjelles-vajsjelles, etj.
 10. Rruge auto kategoria V dhe VI.
 11. Projektim shtresa rrugore e sistem - asfalti.
 12. Projektim ura dhe vepra arti deri ne 10 m.
 13. Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m - Eskada.
 14. Projektim impiante te prodhimit dhe shperndarje te enrgjise elektrike-diellore-era, etj.
 15. Projektim nenstacione elektrike, primare, sekondare - linja te tensionit te larte.
 16. Kabina elektrike te rrejtit shperndares - linja te tensionit te ulet - te mesem.
 17. Te projektoi rrjete telekomunikakioni.
 18. Te projektoi sisteme telekomunikakioni.
 19. Te programoje sisteme telekomunicakioni.
- Import-Export, tregeti shumice e pakice, transport, pika servisi, pjese kembimi per makina dhe automjete.

- Projektimi, hapja dhe shfrytezimi i minierave me qellim prodhimin, perpunimin, transportimin dhe komercializimin e burimeve minerare dhe energjitike ne nentoke dhe siperfaqe, ne kufijte e parashikuar nga ligji.

Per sa me larte kjo kerkese eshte e drejte dhe duhet pranuar

Per kete arsye

Ne baze te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 dhe ligjit Nr.7638 date 19.11.1992,

V e n d o s a

Pranimin e kerkeses.

Depozitim prane Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Shkalles Pare Tirane te Vendimit Nr.5 date 07.04.2005, te Ortakut te Vetem te Shoqerise "OTTO-AL" shpk i cili ka te beje me shtimin e objektiti te veprimtarise te kesaj shoqerie.

Te pasqyrohen ndryshimet ne kolonat perkatese te regjistrimit.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

Gjyqtare

'Anoua Coco'




Republika e Shqiperise
Gjykata e Shkalles Pare Tirane
Nr _____ Vendimi

21020 / 12

V E N D I M

"I gjyqtarit te vetem"

Sot, me daten 2 / 6 / 2005, une gjyqtari 6.31.8, prane Gjykates Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova materialet e paraqitura nga kerkuesi ne emer te shoqerise "OTTO-AL" Shpk .

K O N S T A T O V A

Se me Vendim Nr.21020 date 12.03.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare emeruar **"OTTO-AL" shpk.**

Me vendim Nr.6, dt.25.05.2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise "OTTO-AL" Shpk eshte vendosur: zmadhimi i kapitalit te shoqerise, zmadhim ky ne natyre; miratimin e caktimit te Z. Agim Binaj si ekspert per te bere vleresimet e duhura ne lidhje me kete zmadhim si dhe depozitimin e ketij vendimi prane regjistrit Tregtare te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Per sa me siper kjo kerkese eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

Per keto arsye,

Bazuar ne ligjin Nr 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare",

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane regjistrit tregtare te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit Nr.6, date 25.05.2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise "OTTO-AL" Shpk .

Te pasqyrohen ndryshimet ne kolonat perkatese te regjistrit.
Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

G J Y Q T A R E

Abdulla B. 7
8/3/05

Republika e Shqiperise
Gjykata e Shkalles I are Tirane
Nr. 21020 / 7 Vendimi

V E N D I M

"I gjyqtarit te vetem"

Sot, me daten 28/7/2005, une gjyqtari G. Y., prane Gjykates Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova materialet e paraqitura nga kerkuesi ne emer te shoqerise "Otto-Al" Shpk.

K O N S T A T O V A

Se me Vendim Nr. 21020 date 12.03.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik, shoqeria tregtare e emertuar "Otto-Al" Shpk.

Me vendimin Nr 21020/7, dt. 02.06.2005 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, eshte vendosur:

Zmadhimi i kapitalit te shoqerise, zmadhim ky ne natyre; miratimin e caktimit te Z.Agim Binaj si ekspert per te bere vleresimet e duhura ne lidhje me kete zmadhim si dhe depozitimin e ketij vendimi prane regjistrarit Tregtare te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Me vendimin Nr.7, dt. 05.07.2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise "Otto-Al" shpk, eshte vendosur miratimi Aktit te Ekspertimit te perpiluar nga eksperti Z.Agim BINAJ ne lidhje me zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "Otto-Al" shpk me kontribut ne natyre i vleresuar ne masen 37.700.000 leke (tridhjeteshtatemilioneshtateqindmije) leke, zmadhim nga i cili kapitali themeltar i shoqerise nga 100.100.000 (njqindmilioneqindmije) leke shkon ne masen 136.800.000 (njqinetridhjehstetmilioneqindmije) leke, si dhe depozitim i ketij vendimi prane regjistrarit tregtare te gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Per sa me siper kjo kerkese eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

Per keto arsye,

Bazuar ne ligjin Nr 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare",

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitim prane regjistrir tregtare te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit Nr.7, date 05.07.2005 te Orakut te Vetem te shoqerise "Otto-Al" Shpk dhe te Aktit te Ekspertimit dhe dokumentave bashkelidhur tij.

Te pasqyrohen ndryshimet ne kolonat perkatese te regjistrir.
Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE

Charles B. J.
[Signature]

[Signature]

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ANONIME

“FASSA & BERBERI” SH.A.



Ne mbështetje dhe zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare” dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, themelohet shoqëria anonime pa oferte publike e emërtuar “FASSA & BERBERI” Sh.a. (me poshtë në këtë akt e quajtur “Shoqëria”), nga Aksionerët:

1. “FASSA INTERNATIONAL” S.A., e krijuar në baze të ligjeve të Luksemburgut, me seli në adresën 3A, rue G. Kroll a L – 1882, Luxembourg, me numër regjistri No. B 86030 në Regjistrin Tregtar të Luksemburgut, përfaqësuar nga Z. Paolo Fassa.
2. “OTTO-AL” Sh.p.k., e krijuar në baze të ligjeve të Shqipërisë me vendimin e Gjykatës Nr. 21020, datë 12/03/1999, me seli në adresën Rruga e Elbasanit, pallati pranë Fakultetit të Gjeologji Minierave, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Isuf Berberi.

Kapitali themeltar i Shoqërisë Anonime “FASSA & BERBERI” Sh.a. është 20,000,000.00 (njëzet milion) Lek, i ndarë në 1,000 (njemijë) aksione me një vlerë nominale prej 20,000 (njëzet mijë) Lek secili, të numeruara me numër seri nga 1 deri në 1,000, të zotëruara nga Aksionerët si më poshtë:

Aksioneri “FASSA INTERNATIONAL” S.A. ka kontribuar në kapitalin themeltar me vlerën prej Lek 14,800,000.00 (katërmëdhjetë milion e tetëqind mijë) duke i koresponduar 74% (shtatëdhjetë e katër) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Aksioneri “OTTO-AL” Sh.p.k. ka kontribuar në kapitalin themeltar me vlerën prej Lek 5,200,000.00 (pesë milion e dyqind mijë) duke i koresponduar 26% (njëzet e gjashtë) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë Anonime “FASSA & BERBERI” Sh.a. është:

- Veprimtari të ndryshme tregtare, import – eksport;
- Veprimtari të ndryshme prodhuese vecanerisht të përqendruara në prodhimin e materialeve të ndërtimit;
- Veprimtari në fushën e ndërtimit kryesisht e përqendruar në sektorin e shërbimeve energjitike, hidro, të ndërtimit dhe shfrytëzimit të minierave, etj.
- Veprimtari të tjera të lejuara nga legjislacioni Shqiptar.

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe të pacaktuar.



Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane, ne adresen, Rruga e Elbasanit, pallati prane fakultetit Gjeologji dhe Miniera, Tirane, Shqiperi.

Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise per periudhen e pare prej pese vjetesh do te jete Z. Isuf Berberi, i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e perditshem te aktivitetit te shoqerise, perfageson shoqerine ne marrdhenie me te tretet pervec kompetencave qe ligji dhe Statuti ia jep shprehimisht asamblese se aksionereve dhe per ceshtje te nje rendesie te vecante do te mare miratim nga asambleja.

Organet drejtuese te Shoqerise Anonime "FASSA & BERBERI" Sh.a. jane:

- 
- Asambleja e Aksionereve (e zakonshme, e jashtezakonshme)
 - Keshilli Mbikqyres
 - Drejtoria

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane:

- Z. Paolo Fassa, Kryetar
- Z. Doni Berberi, Nenkryetar
- Z. Bortolo Fassa, Anetar

Eksperti i pare kontabel i autorizuar i shoqerise anonime "FASSA & BERBERI" eshte Z. Qani Kajo.


AKSIONERET E SHOQERISE

"FASSA & BERBERI" Sh.a.

"FASSA INTERNATIONAL" S.A.

Z. Paolo FASSA


Perfaqesues i aksionerit



"OTTO-AL" Sh.p.k.

Z. Isuf BERBERI

Perfaqesues i aksionerit



STATUTI
I SHOQERISE ANONIME
“FASSA & BERBERI” Sh.a.

Ne baze te ligjit 7638, date 19/11/1992 “Per Shoqerite Tregtare”, dhe ligjit nr. 7667, date 28/01/1993 “Per Regjistrin Tregtar” aksioneret:

Shoqerite “FASSA INTERNATIONAL” S.A. dhe “OTTO-AL” Sh.p.k., ne cilesine e aksionereve te shoqerise anonime “FASSA & BERBERI” Sh.a. vendosen miratimin e ketij Statuti me dispozitat e meposhtme:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

FORMA

Krijohet Shoqeria Aksionere e tipit pa oferte publike, si Person Juridik dhe fiton personalitet juridik qe nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj.


NENI 2

EMERTIMI

Emertimi i shoqerise eshte “FASSA & BERBERI” Sh.a.

Ne cdo akt te leshuar nga shoqeria eshte e detyrueshme te deklarohet “FASSA & BERBERI” Sh.a. (inicialet Sh.a. perfaqesojne tipin e Shoqerise)

NENI 3



SELIA

Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane, ne adresen, Rruga e Elbasanit, pallati prane fakultetin Gjeologji dhe Miniera. Shoqeria mund te krijojë filiale, dege dhe perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise sipas nevojave te saj me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

Selia e Shoqerise mund te transferohet me Vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

NENI 4

STEMA DHE VULA E SHOQERISE

Shoqeria Anonime pa oferte publike "FASSA & BERBERI" Sh.a. ka stemon dhe vulen e saj, e cila percaktohet nga mbledhja e pare e Asamblese se Zakonshme te Shoqerise.

NENI 5

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete per nje periudhe te pacaktuar. Ajo fillon qe ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

NENI 6

OBJEKTI

Objekti i veprimtarise se Shoqerise Anonime "FASSA & BERBERI" Sh.a. eshte:

- Veprimtari te ndryshme tregtare, import -- eksport;
- Veprimtari te ndryshme prodhuese vecanerisht te perqendruara ne prodhimin e materialeve te ndertimit;
- Veprimtari ne tushen e ndertimit kryesohet e perqendruar ne sektorin e sherbimeve energjitike, hidro, te ndertimit dhe shfrytezimit te minierave, etj.
- Veprimtari te tjera te lejuara nga legjislacioni Shqiptar.

Ndryshimi, shtimi ose pakesimi i aktiviteteve qe perbejne objektin e veprimtarise se Shoqerise behet me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

KREU II

NENSHKRIMI I KAPITALIT, AKSIONET DHE SHLYERJA E TYRE

NENI 7

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i Shoqerise Anonime "FASSA & BERBERI" Sh.a. eshte 20,000,000.00 (njetzet milion) Lek, i ndare ne 1,000 (njemije) aksione me nje vlere nominale prej 20,000 (njetzetmije) Lek secili, te numeruara me numer serie nga 1 deri ne 1,000.

Derdhjet evidencohen nga nje certifikate e mbajtësit të fondeve, e hartuar në momentin e depozitimit të fondeve, mbi bazën e listës së aksionarëve ku janë shënuar shumat e derdhura nga secili prej tyre.

NENI 8

NENSHKRIMI I KAPITALIT

Nenshkrimi i kapitalit eshte bere nga aksioneret sipas menyres se meposhtme:

Aksioneri "FASSA INTERNATIONAL" S.A. ka kontribuar ne kapitalin themeltar me vleren prej Lek 14,800,000.00 (katërmbedhjetë milion e teteqindmije) duke i koresponduar 74% (shtatedhjetë e kater) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Aksioneri "OTTO-AL" Sh.p.k. ka kontribuar ne kapitalin themeltar me vleren prej Lek 5,200,000.00 (pesemilion e dyqindmije) duke i koresponduar 26% (njetzet e gjashte) te kapitalit themeltar te shoqerise.

NENI 9

AKSIONERET E SHOQERISE

Aksioneret e Shoqerise Anonime "FASSA & BERBERI" SH.A jane kompanite e meposhtme:

1. "FASSA INTERNATIONAL" S.A., e krijuar ne baze te ligjeve te Luksemburgut, me seli ne adresen 3A, rue G. Kroll a L – 1882, Luxembourg, me numer regjistri No. B 86030 ne Regjistrin Tregtar te Luksemburgut, perfaqesuar nga Z. Paolo Fassa.



2. "OTTO-AL" Sh.p.k., e krijuar ne baze te ligjeve te Shqiperise me vendimin e Gjykates Nr. 21020, date 12/03/1999, me seli ne adresen Rruga e Elbasanit, pallati prane Fakultetit te Gjeologji Minerave, Tirane, perfaqesuar nga Z. Isuf Berberi.

Aksioneret e Shoqerise mund te jene persona fizik ose juridik vendas ose te huaj qe kane vene ose do te vene ne zoterim aksione te Shoqerise "FASSA & BERBERI" Sh.a. me te gjitha menytrat e parashikuara ne ligj.

NENI 10

TE DREJTAT DHE DETYRAT E AKSIONEREVE

Cdo aksioner i shoqerise ka te drejten e informimit mbi aktivitetin e shoqerise dhe dokumentacionin qe pasqyron kete aktivitet.

Cdo aksioner i shoqerise ka te drejten e pjesemarrjes ne shperndarjen e fitimeve te shoqerise ne perputhje me kontributin e tij ne kapitalin e shoqerise te nenshkruar dhe te paguar.

Cdo aksioner mund te marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Aksionereve.

NENI 11

ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Zmadhimi i kapitalit themeltar behet nepermjet emetimit te aksioneve te reja ose nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve ekzistuese.

Aksionet e reja shlyhen me para ne dore, me kompensim te nje kredie me para te kerkueshme dhe te detyruar per t'u shlyer nga shoqeria, me perfshirje te rezervave, fitimeve apo primeve te emetimit, me kontribut ne natyre ose me shnderrim te obligacioneve.

Zmadhimi i kapitalit nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve behet vetem me pelqimin unanim te aksionereve, me perjashtim te rastit kur ai realizohet me perfshirjen e rezervave, fitimeve apo primeve te emetimit.

Aksionet e reja emetohen me vleren nominale ose me vleren e rritur qe perfshin primet e emetimit.

NENI 12

Asambleja e jashtëzakonshme është organi i vetem kompetent për të vendosur në mbledhjen e saj zmadhimin e kapitalit mbi bazën e raportit të drejtorisë.

Në rast se zmadhimi i kapitalit realizohet me përfshirje të rezervave, të fitimeve ose primeve të emetimit, asambleja merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm në qoftë se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë të paktën 1/4 e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën nuk kërkohet asnjë lloj quorumi. Asambleja merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

Asambleja mund t'i delegojë drejtorisë kompetencat e nevojshme për të realizuar zmadhimin e kapitalit, një ose disa herë, për të fiksuar modalitetet, për të ndjekur realizimin dhe për të proceduar për ndryshimin përkatës të statutit.

Ne asnjë rast drejtoria nuk ka kompetencën për të vendosur mbi zmadhimin e kapitalit.

NENI 13

Zmadhimi i kapitalit duhet të kryhet brenda 5 vjetëve nga data në të cilën asambleja ka vendosur ose ka dhënë autorizim për këtë.

Përpara se të bëhet çdo emetim aksionesh të reja që shlyhen me para në dorë, duhet që kapitali të jetë shlyer plotësisht, përndryshe operacioni konsiderohet i pavlefshëm.

Aksionet japin të drejtë përparësie në nënshkrim për rritjen e kapitalit. Aksionarët kanë të drejtë përparësie në nënshkrim për rritjen e kapitalit me para në dorë, proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotërojnë. Çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme.

Gjatë kohës së nënshkrimit kjo e drejtë është e tregtueshme, kur ajo lidhet me aksionet që janë vetë të tregtueshme; në të kundërt, ajo është e transferueshme me të njëjtat kushte si dhe vetë aksioni. Kushtet për dhënien e aksioneve të reja të panënshkruara dhe për shpërndarjen e tepricës së tyre përrcaktohen nga asambleja.

NENI 14

ZVOGELIMI I KAPITALIT

Zvogellimi i kapitalit autorizohet dhe vendoset nga Asambleja e Jashtezakonshme në mbledhjen e saj, e cila mund t'i japë Drejtorisë të gjitha kompetencat për ta realizuar.

Në të gjitha rastet zvogelimi prek aksionaret në të njëjtën masë në përpjesëtim me vlerën e aksioneve që zotërojnë.

Projekti i zvogelimit të kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel të autorizuar, të paktën 45 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Aksionereve që thirret për të vendosur mbi këtë projekt. Asambleja merr vendimin mbi raportin e eksperteve kontabel, të cilët japin vlerësimin e tyre mbi shkaqet dhe kushtet e zvogelimit.

Kur operacioni realizohet nga Drejtoria, i cila është e ngarkuar nga Asambleja, ajo harton një procesverbal që shpallet publikisht dhe vepron për ndryshimin përkatës në këtë statut.

Te gjitha procedurat per kundershkrimin ndaj zvogelimit te kapitalit, do te ndiqen sipas percaktimeve te ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 15

FORMA E AKSIONEVE

Aksionet paraqiten ne formen e aksioneve per pruresin ose te aksioneve nominative.

Pronesia e aksioneve rezulton nga regjistrimi i tyre ne librin e aksioneve i cili mbahet prane selise qendrore te shoqerise. Aksioneri ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje ekstrakt nga libri i aksioneve, i cili vertetohet me vulen e shoqerise.

Aksioneri ka te drejte, ne cdo kohe, te verifikojë nese emri i tij eshte regjistruar ne librin e aksioneve dhe te verifikojë aksionet qe jane per llogari te tij.

NENI 16

SHITJA DHE TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Aksionet jane te tregtueshme vetem pas regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe ne rastin e nje rritje kapitali pas regjistrimit te ketij ndryshimi.

Aksioni per pruresin transferohet pa asnjë lloj procedure. Aksioni nominativ u transferohet të tretëve dhe personit juridik emetues nëpërmjet një transferimi në regjistrat, që shoqëria mban për këtë qëllim dhe që përmbajnë treguesit përkatës të operacioneve të transferimit dhe të shndërrimit të aksioneve dhe në vecanti:

- datën e operacioneve;
- emrat, mbiemrat dhe adresat e banimit të titullarit të vjetër dhe atij të ri në rast transferimi;
- emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të titullarit të aksioneve, në rast shndërrimi të aksioneve për pruresin në aksione nominative;
- vlerën nominale dhe numrin e aksioneve të transferuar ose të shndërruar.

NENI 17

Me përjashtim të rasteve të trashëgimisë, transferimi i pronësisë mbi aksionet nga një personi të tretë, pavarësisht nga baza juridike e këtij transferimi, mund t'i nënshtrohet pëlqimit të shoqërisë. Ky pëlqim mund të kërkojë vetëm kur aksionet kanë formën nominative në bazë të ligjit ose të statutit.

Shoqërisë i dorëzohet një kërkesë miratimi ku tregohen emri, mbiemri dhe adresa e personit që i transferohet pronësia, numri i aksioneve që parashikon transferimi i pronësisë dhe çmimi i ofruar, në qoftë se statuti përmban një klauzolë për kërkesa të tilla.

Në qoftë se shoqëria nuk miraton personin e propozuar për transferimin e pronesisë, drejtoria detyrohet që brenda tre muajsh, që nga data e njoftimit të refuzimit, të blejë aksionet, nëpërmjet një aksionari ose personi të tretë apo me pëlqimin e personit që humb pronësinë nga vet shoqëria, me qëllim të zvogëlimit të kapitalit.

Në qoftë se pas perfundimit të afatit prej 3 muajsh blerja nuk është realizuar, miratimi për transferimin e pronësisë konsiderohet i dhënë. Megjithatë ky afat mund të zgjatet me vendim gjyqi sipas kërkesës së shoqërisë.



KREU III

DREJTIMI DHE MENAXHIMI I SHOQERISE

NENI 18

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te Shoqerise Aksionere "FASSA & BERBERI" Sh.a. jane:

- Asambleja e Aksionereve (e zakonshme, e jashtezakonshme)
- Keshilli Mbikqyres
- Drejtoria

NENI 19

ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

Asambleja e aksionereve eshte organi suprem i shoqerise dhe perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote dhe vendimet e saj merren ne perputhje me ligjin dhe kete statut dhe jane te detyrueshme per te gjithë aksioneret dhe shoqerine. Asambleja mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme, sipas rendesise dhe llojit te ceshtjeve qe do te shqyrtohen dhe vendosen.

Mbledhja e asamblesë thirret nga Këshilli Mbikëqyrës ose nga Drejtoria.

Në mungesë ajo thirret gjithashtu:

1. Nga ekspertët kontabël të autorizuar;
2. Nga një mandatmbajtës, i caktuar nga gjyqi, me kërkesën e çdo personi të interesuar për një rast urgjent, ose të një apo disa aksionarëve që zotërojnë së bashku të paktën 1/10 e kapitalit themeltar;
3. Nga likuiduesit.

Mbledhjet e asamblesë të aksionarëve mbahen në selinë e shoqërisë, kur nuk përcaktohet ndryshe.

NENI 20

Thirrja e mbledhjeve të asamblesë së aksionarëve bëhet nëpërmjet lajmërimit me shkrim që i dergohet aksionereve në adresën tyre me shpenzimet e kompanisë.

Njoftimi që duhet të bjerë në dorën e aksionarëve apo të njihet prej tyre, të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë, përcakton ditën, orën dhe vendin ku bëhet mbledhja, si dhe natyrën e jashtëzakonshme, të zakonshme apo të veçantë dhe rendin e ditës.

Çdo mbledhje asambleje që thirret në mënyrë të parregullt, mund të anulohet. Megjithatë veprimi i anulimit nuk pranohet, kur të gjithë aksionarët janë prezent apo të përfaqësuar.

NENI 21

Një aksionar mund të përfaqësohet nga një tjetër aksionar apo nga bashkëshorti.

Çdo aksionar mund të marrë kompetencat që i japin aksionarët e tjerë, me qëllim që t'i përfaqësojë ata në mbledhjen e një asambleje pa kufizime të tjera, përveç atyre që rrjedhin nga kufizimet ligjore apo nga statuti, duke përcaktuar numrin maksimal të votave që mund të zotërojë i njëjti person qoftë në emër të tij, qoftë si mandatarbajtës.

Mandati jepet vetëm për një mbledhje asambleje. Ai ndërkaq mund të jepet për dy mbledhje asambleje, nga të cilat një e zakonshme dhe tjetra e jashtëzakonshme, që mbahen në të njëjtën ditë ose brenda 7 ditësh.

Mandati i dhënë për një mbledhje asambleje, është i vlefshëm për mbledhjet e tjera të asamblesë, të cilat thirren në vazhdim me të njëjtin rend dite.

Cdo klauzole që bie në kundërshtim me rregullat e paragrafeve të mësipërm, konsiderohet e pavlefshme.

NENI 22

Drejtoria duhet, të paktën 15 ditë përpara ditës së mbledhjes së asamblesë, t'u dërgojë apo t'u vërë në dispozicion aksionarëve dokumentet e nevojshme, për t'u bërë të mundur atyre që të njihen dhe të japin një gjykim të plotë mbi administrimin dhe ecurinë e punëve të shoqërisë.

Këto dokumente përmbajnë veçanërisht:

1. Rendin e ditës të mbledhjes së asamblesë;
2. Tekstin e projektrezolutave të paraqitura;
3. Një pasqy-ë përmbledhëse të gjendjes së shoqërisë gjatë vitit financiar që ka kaluar, e shoqëruar me një tabelë ku jepen rezultatet e çdo viti financiar gjatë 5 vjetëve të fundit;
4. Raportin e ekspertëve kontabël të autorizuar, i cili, nëse është i nevojshëm, do t'i paraqitet asamblesë kur bëhet fjalë për një mbledhje të jashtëzakonshme të saj.

Në rast se rendi i ditës përfshin emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, jepen edhe:

a) emri, mbiemri dhe moshë e kandidatëve, të dhënat profesionale dhe aktiviteti i tyre profesional gjatë 5 vjetëve të fundit, veçanërisht funksionet që ushtrojnë apo kanë ushtuar në shoqëri të tjera;

b) punët që kryejnë dhe funksionet që zënë kandidatët në shoqëri dhe numrin e aksioneve që ata kanë në shoqëri, për të cilat ata janë titullarë apo prurës.

NENI 23

ASAMBLEJA E ZAKONSHME

Mbledhja e Asamblese se Zakonshme mbahet ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te percaktuar ne njoftim.

Asambleja e Zakonshme shqyrton dhe vendos per te gjitha ceshtjet qe nuk i perkasin Asamblese se Jashtezakonshme sipas Statutit apo ligjit, dhe ne vecanti:


- Emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres, Ekspertit Kontabel;
- Percakton shperblimet e anetareve te Keshillit Mbikqyres, Ekspertit Kontabel;
- Aprovon marreveshjet, e paraqitura nga Keshilli Mbikqyres ne perputhje me autorizimin perkates per kete qellim;
- Shqyrton dhe vendos mbi te gjitha ceshtjet financiare te vitit financiar qe ka kaluar;
- Miraton Bilancin, Relacionet e Keshillit Mbikqyres dhe Ekspertit Kontabel;
- Autorizon emetimin e obligacioneve dhe nxjerrjen e akteve te vecanta te sigurimit qe lidhen me to;
- Aprovon ndarjen e fitimit, dividendit;
- Aprovon planet e organizimit dhe te zhvillimit te aktivitetit;

Asambleja e zakonshme thirret në mbledhje të paktën një here në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar. Ky afat mund të zgjatet me vendim gjyqësor. Per procedurat e thirrjes, njoftimeve dhe zhvillimit te mbledhjes se Asambles te Zakonshme zbatohen rregullat e percaktuara ne Ligjin Nr. 7638, date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Aksioneret eventualisht duhet te njoftohen edhe per personat e tjere qe do te thirren dhe per arsyen e thirrjes se tyre ne mbledhjen e Asamblese. Organizatoret e mbledhjes ne njoftim mund te kerkojne nga aksioneret qe brenda nje afati te caktuar te konfirmojne prezencen e tyre ne mbledhje me shkrim, apo me menyra te tjera te provueshme komunikimi.

Per vlefshmerine e vendimeve te Asamblese te Zakonshme, ne mbledhjen e pare duhet te jene te pranishem aksioneret qe zoterojne te pakten 1/4 e aksioneve me te drejte vote. Ne mbledhjen e dyte nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e Zakonshme merr vendime te vlefshme me shumicen e thjeshte (50% +1) te votave te aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar.



NENI 24

ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME

Vetëm asambleja e jashtëzakonshme ka kompetenca të ndryshojë statutin me të gjitha dispozitat e tij. Çdo klauzolë e kundërt konsiderohet e pavlefshme. Sidoqoftë ajo nuk mund të shtojë detyrimet e aksionarëve, përveç operacioneve që rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.

Ne mbledhjen e parë Asambleja e Jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm kur aksionerët e pranishëm zoterojnë të paktën $\frac{1}{2}$ e aksioneve me të drejtë vote dhe në mbledhjen e dytë kur janë të pranishëm aksionerët që zoterojnë të paktën $\frac{1}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote. Në mungesë të këtij quorumi mbledhja e dytë e asamblesë mund të shtyhet për një ditë të mëvonshme, jo më të largët se dy muaj nga data e thirrjes së parë.

Asambleja e Jashtëzakonshme merr vendime të vlefshme me një shumicë votash prej $\frac{3}{4}$ që u perkasin aksionerëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

NENI 25

KESHILLI MBIKËQYRËS

PERBERJA E KESHILLIT MBIKËQYRËS

Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë dhe jo më shumë se 21. Numri i anëtarëve duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me tre. Asnjë anëtar i keshillit mbikëqyrës nuk mund të jetë anëtar i Drejtorisë. Në rast se një anëtar i keshillit mbikëqyrës emërohet anëtar i Drejtorisë, mandati i tij në Këshillin Mbikëqyrës përfundon sapo ai të kalojë në funksionin e ri.

Anëtarët e Keshillit Mbikëqyrës zgjidhen sipas procedurave të parashikuara në nenet 105-116 të ligjit Nr. 7638 për "Shoqëritë Tregtare".

Këshilli i parë Mbikëqyrës përbëhet nga 3 anëtarë.

Këshilli Mbikëqyrës zgjedh nga gjiri i tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar që ngarkohen me mbledhjen e keshillit dhe drejtimin e debatit gjatë seancave të tij. Kryetari dhe zëvendëskryetari i Keshillit Mbikëqyrës janë persona fizikë dhe nuk mund të zgjidhen ndërmjet përfaqësuesve të personave juridikë, përndryshe emërimi i tyre është i pavlefshëm. Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjatë tërë periudhës së mandatit të Keshillit Mbikëqyrës.

NENI 26

Në rastin e vendeve bosh që krijohen nga vdekja apo dorëheqja e një apo disa anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës, ky Këshill mundet, për periudhën midis dy mbledhjeve të asamblesë, të bëjë emërimet të përkohshme.

Kur numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ka zbritur nën minimumin ligjor, Drejtoria duhet të thërrasë urgjentisht mbledhjen e zakonshme të asamblesë për të plotësuar efektivin e Këshillit Mbikëqyrës.

Kur numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ka zbritur nën minimumin e kërkuar në statut, por është jo më i vogël se minimumi ligjor, Këshilli mbikëqyrës brenda tre muajve nga data e krijimit të vendeve bosh, duhet të bëjë emërimet të përkohshme për të kompletuar efektivin e tij.

Emërimet e bëra nga Këshilli, në bazë të paragrafeve 1 dhe 3 të këtij neni, i nënshtrohen ratifikimit në mbledhjen e rradhës të asamblesë së zakonshme. Në mungesë të ratifikimit, shqyrtimet e bëra dhe vendimet e marra më parë nga Këshilli mbeten gjithmonë të vlefshme. Kur Këshilli lë pas dore bërjen e emërimeve të kërkuara apo nëse asambleja nuk thirret, çdo i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore caktimin e një mandatmbajtësi të ngarkuar për thirrjen e asamblesë, e cila do të bëjë emërimet.

NENI 27

Këshilli mbikëqyrës nuk mund të marrë vendime të vlefshme, pa qenë e pranishme të paktën gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm ose përfaqësuesve të tyre, me përjashtim të rastit kur në statut parashikohet një shumicë më e lartë. Vota e kryetarit është përcaktuese, në rast rezultati të barabartë votash, po që se në statut nuk përcaktohet ndryshe.

NENI 28

KOMPETENCAT E KESHILLIT MBIKQYRES

Këshilli mbikëqyrës ushtron kontroll të vazhdueshëm ndaj Drejtorisë për administrimin e shoqërisë nga ana e saj.


Këshilli mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikimet dhe kontrollet që ai i çmon të arsyeshme dhe të kërkojë të njihet me dokumentet që ai i gjykon të nevojshme për plotësimin e detyrës së tij. Drejtoria i paraqet raport Këshillit Mbikëqyrës të paktën një herë në tre muaj.

Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar, Drejtoria i paraqet Këshillit Mbikëqyrës llogarite vjetore dhe sipas rastit edhe ato të konsoliduara me qëllim verifikimi dhe kontrolli.

Këshilli Mbikëqyrës i paraqet asamblesë vërejtjet e tij mbi raportin e Drejtorisë, si dhe ato mbi llogaritë e vitit financiar.

NENI 29

SHPERBLIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT MBIKQYRES



Kompetente për përcaktimin e mënyrës dhe masës së shpërblimit të antarëve të Këshillit Mbikqyres është Asambleja e Zakonshme.

NENI 30

EMERIMI I ANETAREVE TË PARË TË KESHILLIT MBIKQYRES

Anëtarët e parë të Këshillit Mbikqyres janë:

Z. Paolo Fassa, Kryetar

Z. Doni Berberi, Nenkryetar

Z. Bortolo Fassa, Anëtar

NENI 31

DREJTORIA

Shoqëria drejtohet nga një Drejtori e përbërë nga një ose disa anëtarë. Drejtoria ushtron funksionet e saj nën kontrollin e Këshilli Mbikëqyrës.

Anëtarët e Drejtorisë emërohen nga Këshilli Mbikëqyrës që ngarkon njërin prej tyre me cilësinë e drejtorit. Anëtarët e drejtorisë janë persona fizikë, në të kundërt emërimi i tyre është i pavlefshëm. Ata mund të zgjidhen edhe jashtë bashkësisë së aksionarëve.

Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën e parë prej pesë vjetësh është Z. Isuf Berberi.

NENI 32

SHKARKIMI I ANËTARËVE TË DREJTORISË

Anëtarët e drejtorisë mund të shkarkohen për shkaqe të përligjura nga Këshilli Mbikëqyrës. Si shkaqe të përligjura konsiderohen veçanërisht një faj i rëndë i anëtarit të Drejtorisë, paafësia e tij në kryerjen korrekte të funksioneve ose kur asambleja humbet besimin tek ai.

NENI 33

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të drejtorisë caktohet në statut për një periudhë nga dy deri gjashtë vjet. Nëse vendi mbetet bosh, zëvendësuesi emërohet për periudhën që mbetet deri në emërimin e drejtorisë së re.

Mënyra dhe masa e shpërblimit të secilit anëtar të Drejtorisë fiksohet me aktin e emërimit.

NENI 34

KOMPETENCAT E DREJTORISË DHE VENDIMMARRJA

Drejtoria ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë. Ajo i ushtron këto kompetenca brenda objektit të shoqërisë, por kufizohet nga ato kompetenca që ligji ua jep shprehimisht këshillit mbikëqyrës dhe asambleve të aksionarëve.

Shoqëria në marrëdhëniet me të tretët merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e drejtorisë, edhe kur këto akte nuk përfshihen në objektin e shoqërisë. Shoqëria nuk përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i drejtorisë e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin se vetë shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e drejtorisë duhet të respektohen nga të tretët. Drejtoria shqyrton dhe merr vendime sipas kushteve të caktuara në statut.

NENI 35

PËRFAQËSIMI TEK TË TRETËT

Anëtarët e drejtorisë, në rast se drejtoria përbëhet nga disa anëtarë, përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët, po qe se në statut nuk përcaktohet ndryshe. Statuti mund t'i njohë këshillit mbikëqyrës të drejtën për t'u dhënë njërit apo disa anëtarëve të drejtorisë kompetencën e përfaqësimit të shoqërisë vetëm apo së bashku me një anëtar tjetër.

Ankesat apo kërkesat që të tretët i adresojnë shoqërisë, janë të vlefshme kur ato dërgohen te drejtori.

Anëtarët e drejtorisë që kanë kompetencën e përfaqësimit bashkërisht të shoqërisë, mund t'u ngarkojnë disa prej tyre kompetencën e përfaqësimit të vetëm për disa operacione specifike ose për disa kategori specifike operacionesh.

Dispozitat e statutit që kufizojnë kompetencat e përfaqësimit të shoqërisë, duhet të respektohen nga të tretët.

KREU IV

KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 36

KONTROLLI I SHOQERISE, EKSPERTI KONTABEL

Ne shoqëri kontrolli ushtrohet nga eksperti kontabel i autorizuar. Eksperti kontabel i autorizuar emërohet nga Asambleja e Zakonshme e Aksionereve. Ekspertët kontabël të autorizuar emërohen për një vit financiar. Funkcionet e tyre përfundojnë pas mbledhje së asamblesë së zakonshme, e cila merr vendim mbi llogaritë vjetore. Shoqëria ka të drejtë të emerojë një ose disa të tilla.

Ekspertët Kontabel të autorizuar do t'i nënshtrohen të gjitha papajtueshmërive dhe procedurave të tjera të kundërshtimit nga ana e aksionereve të përcaktuara në ligjin nr.7638 "Për shoqëritë tregtare".

Eksperti i parë kontabel i autorizuar i shoqërisë anonime "FASSA & BERBERI" është Z. Qani Kajo.

NENI 37 SHKARKIMI NGA DETYRA

Në rast gabimi ose pengimi, ekspertët kontabel të autorizuar mund të shkarkohen nga funksionet e tyre me anë të një vendimi të gjykatës, që miratohet dhe vendos me procedurë urgjente.

NENI 38

Ekspertët kontabel të autorizuar garantojnë që llogaritë vjetore janë të rregullta e të hartuara me sinqeritet dhe japin një pasqyrim besnik të rezultateve të operacioneve të vitit të kaluar financiar, si dhe gjendjes financiare e të trashëgimisë së shoqërisë në fund të këtij viti financiar.

Ata kanë për detyrë të përhershme, duke përjashtuar çdo ndërhyrje në administrim, të verifikojnë librat e llogarisë dhe fondet e shoqërisë si dhe të kontrollojnë përshtatjen e kontabilitetit të saj me legjislacionin në fuqi. Ata verifikojnë gjithashtu sinqeritetin dhe përputhjen me llogaritë vjetore të informacioneve të dhëna në raportin e administrimit nga ana e drejtorisë dhe në dokumentet që u janë dërguar aksionerëve mbi gjendjen financiare dhe llogaritë vjetore.

Ekspertët kontabel të autorizuar sigurohen që është respektuar barazia ndërmjet aksionarëve.

Në çdo kohë të vitit ekspertët kontabel të autorizuar, së bashku ose vec e vec, bëjnë të gjitha verifikimet e kontrollet që i gjykojnë të nevojshme dhe mund të shqyrtojnë në vend të gjithë dokumentacionin e vlerësuar si të dobishëm në ushtrimin e detyrës së tyre dhe në vecanti të gjitha kontratat, librat e llogarisë, dokumentet kontabel dhe regjistrat e procesverbaleve. Për kryerjen e kontrolleve të tyre ekspertët kontabel të autorizuar kanë mundësi, nën përgjegjësinë e tyre, të ndihmohen ose të përfaqësohen nga ekspertë ose bashkëpunëtorë që i zgjedhin vetë, emrat e të cilëve duhet t'i bëhen të njohur shoqërisë. Këta kanë të njëjtat të drejta verifikimi e kontrolli si ato të ekspertëve kontabel dhe i nënshtrohen papajtueshmërive të përcaktuara në ligj.

NENI 39

INFORMIMI I ORGANEVE TË SHOQËRISË

Ekspertët kontabel të autorizuar u bëjnë të njohur drejtorisë dhe këshillit mbikëqyrës;
1. Kontrollet dhe verifikimet që kanë kryer dhe sondazhet e ndryshme që kanë bërë;

2. Pjesët e bilancit dhe të dokumenteve të tjera të kontabilitetit në të cilat sipas tyre duhet të ishin bërë ndryshime, duke bërë gjithashtu edhe të gjitha vërejtjet e duhura mbi metodat e vlerësimit të përdorura në përpilimin e këtyre dokumenteve;
3. Parregullshmëritë dhe pasaktësitë që kanë zbuluar;
4. Përfundimet që rrjedhin nga vërejtjet dhe korrigjimet e mësipërme mbi rezultatet e vitit financiar, të krahasuara me ato të vitit financiar të mëparshëm.

NENI 40

USHTRIMI FINANCIAR

Ushtrimi financiar fillon ne date 1 janar dhe mbaron ne date 31 dhjetor te cdo viti kalendarik.

Perjashtimisht, ushtrimi i pare financiar fillon nga data e regjistrimit si person juridik te shoqërisë dhe mbaron me date 31 dhjetor te atij viti.

NENI 41

INVENTARI, LLOGARITE VJETORE

Ne fund te cdo viti financiar, drejtoria ben inventarin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin, te cilat ja paraqet se bashku me bilancin Keshillit Mbikqyres dhe Asamblese se Aksionereve per shqyrtim.

Nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur, nese ka, humbjet e vitit te meparshem, heq menjane nje shume ne masen mbi 5% te fitimit neto, e cila destinohet per formimin e nje fondi rezerve, te quajtur rezerve e domosdoshme. Cdo vendim i kundert eshte i pavlefshem. Kjo lenie menjane nuk perben detyrim kur rezerva e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Asambleja e zakonshme, ne rast nevojë, mund te formoje fonde te tjera, pervec fondeve te percaktuara ne paragrafin e meparshem te ketij neni.


Pas plotesimit te shumes te fondeve te mesiperme, pjesa e mbetur e fitimit, caktohet per ndarje per aksioneret, ne varesi me perqindjet e pjesemarrjes se tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise ose mund te investohet ne baze te vendimit te Asamblese se Zakonshme te aksionereve.

NENI 42

SHKAQET E SHPERNDARJES SE SHOQERISE

Shoqeria shperndahet:

- Me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme



- Kur shoqeria falimenton
- Per cdo shkak tjeter te parashikuar ne ligj

Grumbullimi i te gjitha aksioneve ne nje aksioner, nuk perben shkak per shperndarjen e shoqerise.

NENI 43

LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rastin e shkrirjes shoqeria i nenshtrohet likuidimit. Per likuidimin e shoqerise zbatohen rregullat e percaktuara ne legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 44

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ne interpretimin dhe zbatimin e ketij Statuti dhe te aktit te themelimit te shoqerise si dhe ne pergjithesi te gjitha mosmarreveshjet midis aksionereve persa i perket shoqerise, neqoftese nuk zgjidhen me mirekuptim midis paleve do te zgjidhen ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 45

DISPOZITA PER FUNDIMTARE

Per gjithcka qe nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil dhe te legjislacionit per shoqerite tregtare ne Shqiperi.

NENI 46


Ky Statut u lexua, u firmos dhe u nenshkrua nga aksioneret e shoqerise "FASSA & BERBERI" Sh.a.

AKSIONERET E SHOQERISE

"FASSA & BERBERI" Sh.a.


"FASSA INTERNATIONAL" S.A.

Z. Paolo FASSA
Perfaqesues i Aksionerit



"OTTO-AL" Sh.p.k.

Z. Isuf BERBERI
Perfaqesues i Aksionerit



Translator
Futura
Xhazija
46

OTTO-AL Sh.p.k.

Rruga e Elbasanit,
Pallati prane Fakultetit Gjeologji-Miniera,
Tirane, Shqiperi



**VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME
TE ORTAKUT TE VETEM**

Sot ne daten 07 / 11 / 2006, ne baze te Nenit 57 e vijues te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare", u mbledh Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakut te Vetem te shoqerise "OTTO-AL" Sh.p.k., shoqeri me pergjegjesi te kufizuar shqiptare, zyra e regjistruar e se ciles ndodhet ne Tirane, Rruga e Elbasanit, pallati prane Fakultetit te Gjeologji-Minierave.

Pas shqyrtimit, Ortaku i Vetem mori vendim perkatesisht me rendin e dites si me poshte:

1. Krijimin e shoqerise anonime "FASSA & BERBERI" Sh.a.

Shoqeria "OTTO-AL" Sh.p.k., ne cilesine e aksionerit vendos te krijojte shoqerine anonime "FASSA & BERBERI" Sh.a., ne ortakeri me aksionerin tjeter "FASSA INTERNATIONAL" S.A.,

2. Kapitali themeltar, objekti i aktivitetit, adresa e regjistruar e "FASSA & BERBERI" Sh.a.

Kapitali themeltar i shoqerise "FASSA & BERBERI" Sh.a. eshte 20,000,000.00 (njetzet milion) Lek, i ndare ne 1000 (njemije) aksione me nje vlere nominale te barabarte me 20.000 (njetzetmije) leke secili, te cilat zoterohen nga aksioneret si me poshte:

"FASSA INTERNATIONAL" S.A. zoteron 74% te kapitalit themeltar;

"OTTO-AL" Sh.p.k. zoteron 26% te kapitalit themeltar.

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane, Rruga e Elbasanit, pallati prane Fakultetit te Gjeologji-Minierave.

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Veprimtari te ndryshme tregtare, import - eksport;
- Veprimtari te ndryshme prodhuese vecanerisht te perqendruara ne prodhimin e materialeve te ndertimi;
- Veprimtari ne fushen e ndertimit kryesisht e perqendruar ne sektorin e sherbimeve energjitike, hidro, te ndertimit dhe shfrytezimit te minierave, etj.
- Veprimtari te tjera te lejuara nga legjislacioni Shqiptar.

3. Statuti dhe Akti i Themelimit

Per sa me siper Aksioneret e shoqerise "FASSA & BERBERI" Sh.a. do te hartojne edhe Statutin dhe Aktin e Themelimit te saj te cilat do te depozitohen ne Regjistrin Tregtar sipas procedurave ligjore ne fuqi.

4. Keshilli Mbikqyres

Keshilli i pare Mbikqyres perbehet nga:

Z. Paolo Fassa, Kryetar
Z. Doni Berberi, Nenkryetar
Z. Bortolo Fassa, Anetar

5. Depozitimi i Vendimit

Ortaku i Vetem vendos te depozitohet ky vendim prane Zyres se Regjistrimit Tregtar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe ngarkon Z. Isuf Berberi si perfaqesues te Aksionerit per firmosjen e akteve themeluese te shoqerise "FASSA & BERBERI" Sh.a. si edhe per ndjekjen e procedurave perkatese per regjistrimin e saj.

Per sa me siper u hartua ky vendim, i cili pasi lexohet, firmoset me vullnet te lire nga Ortaku i Vetem.

Ortak i Vetem

Isuf BERBERI

Isuf Berberi

GENERAL CONSTRUCTION
TIRANA ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA


Nr. 182 Rep.

Nr. 29 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne daten Njezete Nentor 2006 (dymije e gjashte) ,diten e hene une notere Eriketa Kokoli, notere ne Tirane, me Seli ne Rrugen "Kont Uran"Nr.20, vertetova firmen e **Isuf Berberi**, i biri i Aranitit, lindur ne 24.08.1969, baneus ne Tirane, Rruga " Dervish Hima", 3 Kullat tek Stadiumi Qemal Stafa, madhore dhe me zotesi te plote juridike, i njohur personalisht prej meje noteres, te vene ne Vendimin e Ortakut te Vetem.

Une noteri pasi e gjeta konform nenit 39 te Ligjes 7829 date 1 Qershor 1994 " Per Noterine " e vertetova si me poshte.



NOTER

Eriketa Kokoli
[Signature]

THEMELIMI I SHOQERISE E DATES 25 JANAR 2002

Viti 2002, date 25 janar

Perpara Mjeshterit Jean **SECKLER**, noter me seli ne Junglinster, (Grand - Duché i Luksemburgut), i nenshkruar;

U PARAQITEN:

1. Shoqeria italiane "**FASSA SRL**", e cila e ka seline e saj sociale ne kete adrese I - 31027 Spresiano (TV), Via Lazzaris 3, (Itali).

2. Shoqeria zviceriane "**FINACQUIS S.A.**", e cila e ka seline e saj sociale ne CH-6340 Baar, 13, Oberdorfstrasse, 13 (Zvicer).

Qe te dyja, ketu, te perfaqesuara nga Zonja Heike **HEINZ**, e punesuar private, e cila e ka seline e punes ne L-1882 Luksemburg, 3A, rruga Guillaume Kroll, sipas dy prokurave te nenshkruara te aktit te paregjistruar noterial qe i jane dorezuar asaj,

Prokura te cilat pasi jane firmosur « Themeluesi » nga personi qe u paraqit perpara noterit dhe noteri i nenshkruar, do ti bashkengjiten ketij akti me te cilin keto prokura do te regjistrohen.

Personi qe u paraqit perpara noterit, ne cilesine me te cilen vepron, vendosi nenet per themelimin e nje shoqerie anonime:

Neni 1. Me kete dokument eshte formuar nje shoqeri anonime me emerimin « **FASSA INTERNATIONAL S.A.** ».

Neni 2. Selia sociale eshte ne Luksemburg.

Selia mund te transferohet ne cdo vend tjeter te Grand - Duché ne Luksemburg me nje vendim te Keshillit te Administrates.

Neni 3. Kohezgjatja e shoqerise eshte e pakufizuar.

Neni 4. Shoqeria ka per qellim pjesemarrjen, ne cfaredolloj forme qofte, ne ndermarrjet tregtare, industriale, financiare , apo te tjera, te Luksemburgut apo te huaja, dhe mund ti vij ne ndihme, qofte ne forme huaje, garancie, paradhenie apo menyra te tjera. Per me teper ka si qellim blerjet, me ane te pjesemarrjes, te ndihmes, marrje fikse apo sipas variantit, te bej marreveshje per blerje, me inskriptime apo cfaredolloj tjeter, si dhe tjetersim me shitje, kembime apo ndonje menyre tjeter sipas te drejtes; detyrime, kredite, kartmonedha,leter me vlere dhe licensa dhe te tjera aksione te te gjitha llojeve, zoterimin, administrimin, zhvillimin dhe menazhimin e portofolit te saj.

Shoqeria mund te marr hua me te gjitha format dhe te vijoj me nxjerrjen e detyrimeve.

Ne nje pamje te pergjithshme, ajo mund te marre te gjitha masat e kontrollit dhe te mbikqyrjes dhe te prishe te gjitha veprimet qe ajo i gjykon te dobishme per permbushjen apo per zhvillimin e qellimit te saj, por gjithmone duke respektuar kufijte e asaj cka eshte shenuar nga ligji i dates 10 gusht 1915 qe ka te beje me shoqerite tregtare.

Neni 5. Kapitali social eshte caktuar **DYQIND E PESEDHJETE MIJE EURO (250.000 EUR)** e ndare ne **NJEZET E PESE MIJE (25.000)** aksione me nga **DHJETE EURO (10 EUR)** secila.

Neni 6. Aksionet jane emerore ose te sjellura, sipas zgjedhjes se aksionereve.

Aksionet e shoqerise mund te krijohen me zgjedhjen e pronarit, si ortak i vetem ose me certifikata perfaqesuese te shume aksioneve.

Shoqeria mund te vijoj me riblerje te aksioneve te saj me ane te rezervave qe permban dhe duke respektuar dispozitat e nenit 49 - 2 te ligjit te vitit 1915.

Neni 7. Shoqeria administrohet nga nje keshill i formuar te pakten nga tre anetare, aksionere ose jo.

Administratoret emerohen per nje periudhe jo me shume se 6 vjet;

Administratoret mund te rizgjidhen por gjithmone edhe shfuqizohen.

Ne rast kur eshte i lire posti i nje administratori, administratoret qe mbeten kane te drejte ta marrin ate provizorisht: ne kete rast asambleja e pergjithshme, gjate mbledhjes se pare, vijon me zgjedhjen perfundimtare.

Neni 8 Keshilli i administrates ka fuqine te permbush te gjitha aktet e nevojshme apo te dobishme per realizimin e qellimit social; gjithcka qe nuk eshte rezervuar ne asamblene e pergjithshme nga ligji ku keto statute jane nen kompetencen e tij.

Keshilli i administrates mund te caktoj presidentin e saj: ne rast mungese te presidentit, prezidenca e mbledhjes mund ti delegohet nje administratori qe eshte i pranishem.

Keshilli i administrates mund te bej shqyrtime vetem nese shumica e anetareve eshte e pranishme ose e perfaqesuar, mandati ndermjet administratoreve, qe mund te jepet me shkrim, me telegram, faks apo ne menyre elektronike, duke qene se pranohen. Ne rast urgjence, administratoret mund te japin voten e tyre me shkrim, me telegram, faks apo menyre elektronike.

Vendimet e Keshillit te administrates merren me shumicen e votave: ne rast ndarje, vota e atij qe drejton mbledhjen mbizoteron. Keshilli mund te delegoj te gjitha ose nje pjese te kompetencave te tij ne lidhje me menaxhimin te perdritshem si edhe perfaqesimin njerit apo me shume administratoreve, drejtoreve, menaxhuesve dhe agjenteve te tjere, aksionere apo jo.

Ai mund ti besoj te gjitha apo nje pjese te administrimit normal te shoqerise, te drejtimit teknik apo tregtar te shoqerise.

Delegacioni me nje anetar te keshillit te administrimit varet nga autorizimi paraprak i asamblese se pergjithshme.

Shoqeria merr vendime me anen e firmosjes se dy administratoreve te shoqerise, ose me anen e nje firme e vetme qe perfaqeson te gjitha personat te cilet e kane marre te drejten e kesaj firme nga keshilli i administrates.

Neni 9. Mbikqyrja e shoqerise i besohet njerit ose me shume te derguarve, aksionere ose jo, te emeruar per nje periudhe kohe jo me shume se gjashte vjet, te cilet rizgjidhen por edhe shfuqizohen.

Neni 10 Viti fiskal fillon me date nje korrik dhe perfundon me 30 qershor te vitit vijues.

Neni 11 Asambleja e pergjithshme vjetore mblidhet me te drejta te plota te henen e dyte te muajit tetor ne oren 09 :00 ne seline sociale ose ne cfaredo vendi qe eshte percaktuar nga fletethirrja.

Nese kjo dite eshte pushim, asambleja do te mbahet ditën e pare qe do te hapet vijuese.

Neni 12. Flete thirrjet per asamblete e pergjithshme jane perpiluar ne perputhje me dispozitat ligjore. Ato nuk jane te nevojshme nese te gjitha aksioneret jane te pranishem apo jane te perfaqesuar, dhe nese kane deklaruar se jane njohur paraprakisht per rendin e dites.

Keshilli i administrates mund te vendos qe, per te patur mundesi te jene te pranishem ne asamblene e pergjithshme, pronari i aksioneve te paralajmeroj 5 dite pune perpara dates se fiksuar per mbledhjen; te gjithë aksioneret do te kene te drejten te votojne secili vete ose me anc te te perfaqesuarit , aksioner apo jo.

Çdo aksioner ka te drejten e nje vote, pervec rasteve kur bie ndesh me ligjin.

Neni 13 Asambleja e pergjithshme e aksionereve ka kompetenca me te gjera per te bere apo per te miratuar aktet qe i interesojne shoqerise.

Ajo vendos per caktimin dhe shperndarjen e fitimit neto.

Neni 14. Sipas rezervave te dispozitave te nenit 72 - 2 te ligjit te vitit 1915 keshilli i administrates autorizohet te vijoj me derdhjen e paradhenies ne dividendet.

Neni 15 Ligji i dates 10 gusht 1915 mbi shoqerite tregtare dhe ndryshimet e metejshme do te zbatohen gjithkund kur nuk bie ndesh me keto statute.

DISPOZITAT E PERHERSHME

- 1) Fillimi i ushtrimit te aktivitetit ekonomik fillon ne ditën e themelimit dhe mbaron me date 30 qershor 2002.
- 2) Asambleja e pare e pergjithshme e zakonshme vjetore do te mbahet ne vitin 2002

DEPOZITIMI DHE SHLYERJA

Personat e paraqitur perpara noterit te parashenuar kane depozituar aksionet e krijuara si me poshte vijon:

1. Shoqeria me te drejte italiane **"FASSA SRL"** , e cila e ka seline e saj ekonomike ne kete adrese I - 31027 Spresiano (TV), Via Lazzaris 3, (Itali). (njezet e kater mije e nenteqind e nentedhjte e nente aksione 24.999
2. Shoqeria me te drejte zviceriane **"FINACQUIS S.A."**, e cila e ka seline e saj ekonomike ne CH-6340 Baar, 13, Oberdorfstrasse, 13 (Zvicer), (nje aksion)

1

Totali njezet e pese mije aksione,

25.000

Te gjitha aksionet jane shlyer me para ne dore ne menyre qe shuma **DYQIND E PESEDHJETE MIJE EURO (250.000 EUR)** te jete ne dispozicion te shoqerise dhe nje gje e tille u vertetua tek noter i domosdoshem i cili e konstatoi kete gje posacerisht.

DEKLARATE

Noteri i domosdoshem deklaroi se ka verifikuar ekzistencen e kushteve te permendura ne nenin 26 te ligjit 10 te dates 10 gusht 1915 mbi shoqerite tregtare, dhe konstaton posacerisht realizimin.

SHPENZIMET

Shuma e shpenzimeve, e pagesave apo detyrimeve financiare ne cfaredo lloj forme qofshin, qe i perkasin shoqerise apo qe jane vene ne ngarkim te saj sipas aktit te themelimit ngrihet afersisht ne shumen e tremije e gjashteqinf e pesedhjte Euro.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E JASHTEZAKONSHME

Sa sipër, personat e paraqitur perpara noterit te lartpermendur, qe perfaqesojne integritetin e kapitalit ekonomik formojne asamble te pergjithshme te jashtezakonshme ne te cilen konsiderohen zyrtarisht te mbledhur, dhe pasi kane

konstatuar se sa siper ishte formuar sic duhet, moren me unanimitet vendimet e meposhtme:

1. Numri i administratoreve eshte percaktuar tre, dhe ai i te deleguarve nje.
2. Jane vendosur ne funksionin e administratoreve:
 - a) Zoti Paolo **FASSA**, sipermarres, me seli pune ne kete adrese I-310027 Spresiano (TV), Piazzetta Giustiniani 14, (Itali).
 - b) Zoti Marc **MULLER**, ekspert kontabel, me seli pune ne kete adrese L-1882 Luksemburg, 3A, rruga Guillaume Kroll.
 - c) Zonja Pascale **LOEWEN**, e punesuar private, me seli pune ne kete adrese L-1882 Luxembourg, 3A, rruga Guillaume Kroll.
3. Emerohet ne funksionin e te deleguarit:
 - Zoti Jean - **Marc FABER**, ekspert kontabel, me seli ne kete adrese L-1449 Luxembourg, rue de l'Eau.
4. Mandatet e administratoreve dhe i te deleuarit do te perfundojne ne fund te asamblese se pergjithshme vjetore te vitit 2007.
5. Selia sociale ndodhet ne kete adrese L-1882 Luksemburg, 3A, rruga Guillaume Kroll.
6. Keshilli i administrates autorizohet te emeroj nje ose disa nga anetaret e tij ne funksionet e administrator - i derguar.

NGA KU AKTI

Eshte perpiluar dhe eshte nenshkruar ne Luksemburg

Data ajo qe eshte shenuar ne fillim

Dhe pas leximit dhe interpretimit te bere personave qe u paraqiten perpara noterit, te njohur nga noteri me mbiemer, emer qe perdorin, moshen dhe vendbanimet, ata firmosen te gjithe me mua noterin kete akt.

HEINZ - J. SECKLER

Regjistruar ne tre kopje pa shtyerje ne Grevenmacher me date 5 shkurt 2002

Volumi 516, fleta 96, Koleksioni 5. Marre dy mije e njeqind EURO.

1% = 2500. - Eur

Marresi: **G. SCHLINK**

PER KOPJO KONFORM

leshuar shoqerise

Junglinster, me 25 shkurt 2005

Firma vula

Apostile

(Konventa e Hages e dates 5 tetor 1961)

1. Vendi: Grand - Duché e Luksemburgut

Ky akt publik

2. eshte firmosur nga Z. Jean **SECKLER**

3. me detyren e noterit

4. dhe qe mban vulen dhe pullen e

Vertetohet

5. ne Luksemburg

6. me 18 tetor 2006

7. nga Ministria e Puneve te Jashtme

8. me Nr. 352869106

9. Vula Pulla

10. Firma

Paul NIRTZ

Inspektori kryesor

Zyra e pasaportave, i Vizave dhe i Legalizimeve



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E T IRANES


Nr. *4819* Rep.

VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyeses FLUTUR XHABIJA-Laknori, me license nr. 3602758, e cila perktheu dokumentin e mesiperm, njelloj me originalin, nga Frengjishtja ne Shqip.

Tirane, *02.11.* 2006

NOTERE PUBLIKE



Grande Kouch
Kouch

EXTRAIT

FASSA INTERNATIONAL S.A.

Numéro d'immatriculation : B 86030

Date d'immatriculation/d'inscription : 25/02/2002

Dénomination(s) ou raison(s) sociale(s) :

FASSA INTERNATIONAL S.A.

Forme juridique : Société anonyme

Siège social :

3A, Rue Guillaume Kroll
L - 1882 Luxembourg

Indication de l'objet social : La société a pour objet la prise de participations, sous quelque forme que ce soit, dans des entreprises commerciales, industrielles, financières, ou autres luxembourgeoises ou étrangères, et peut leur prêter tous concours, que ce soit par des prêts, des garanties, des avances ou de toutes autres manières. Elle a en outre pour objet l'acquisition par achat, par voie de participation, d'apport, de prise ferme ou d'option, d'achat de négociation, de souscription ou de toute autre manière, ainsi que l'aliénation par vente, échange ou de toute autre manière de titres ; obligations, créances, billets, brevets et licences et autres valeurs de toutes espèces, la possession, l'administration, le développement et la gestion de son portefeuille. La société peut emprunter sous toutes les formes et procéder à l'émission d'obligations. D'une façon générale, elle peut prendre toutes mesures de contrôle et de surveillance et faire toutes opérations qu'elle jugera utiles à l'accomplissement ou au développement de son objet, en restant toutefois dans les limites tracées par la loi du 10 août 1915 concernant les sociétés commerciales.

Capital social / fonds social :

Montant : 11.000.000 EUR

Etat de libération: Entièrement libéré

Date de constitution : 25/01/2002

Durée :

Illimitée

Exercice social :

Par exception, l'exercice social ayant débuté en date du 19/05/2005 se terminera en date du 31/12/2005.
Du: 01/01 au: 31/12

Administrateur(s)/gérant(s) :

Régime de signature statutaire : La société se trouve engagée par la signature collective de deux administrateurs de la société, ou par la seule signature de toutes personnes auxquelles pareils pouvoirs de signature auront été délégués par le conseil d'administration.

Organe : Conseil d'administration

Nom : LOEWEN Prénom(s) : Pascale

Fonction : Administrateur

Adresse privée ou professionnelle de la personne physique :

3A, rue G. Kroll, L - 1882 Luxembourg

Durée du mandat : Déterminée Date de nomination : 02/11/2004

Jusqu'à l'assemblée générale qui se tiendra en l'année : 2010

Pouvoir de signature : - engagement à deux

Nom : BOUR Prénom(s) : Denis

Fonction : Administrateur

Adresse privée ou professionnelle de la personne physique :

3A, rue G. Kroll, L - 1882 Luxembourg

Durée du mandat : Déterminée Date de nomination : 02/11/2004

Jusqu'à l'assemblée générale qui se tiendra en l'année : 2010

Pouvoir de signature : - engagement à deux

Nom : FASSA Prénom(s) : Paolo

Fonction : Administrateur

Adresse privée ou professionnelle de la personne physique :

14, Piazzetta Giustiniani, I - 31027 Spresiano

Durée du mandat : Déterminée Date de nomination : 02/11/2004

Jusqu'à l'assemblée générale qui se tiendra en l'année : 2010

Pouvoir de signature : - engagement à deux

Personne(s) chargée(s) du contrôle des comptes:

Nom : FABER Prénom(s) : Jean-Marc

Fonction : Commissaire

Adresse privée ou professionnelle de la personne physique :

63-65, rue de Merl, L - 2146 Luxembourg

Durée du mandat : Déterminée Date de nomination : 02/11/2004

Jusqu'à l'assemblée générale qui se tiendra en l'année : 2010

(*) Extrait de l'inscription : Pour le détail prière de se reporter au dossier.

Pour extrait conforme

Luxembourg, le 11/10/2006

Pour le gestionnaire du registre de commerce et des sociétés



Dina MILHEIRO PEREIRA

EKSTRAKT

FASSA INTERNATIONAL S.A.

NUMRI I REGJISTRIMIT: B 86030

DATA E REGJISTRIMIT: 25/02/2002

EMERIMI(ET) APO ARSYEJA(ET) SOCIALE:

FASSA INTERNATIONAL S.A.

Forma juridike : Shoqeri anonime

Selia ekonomike :

3A, Rruga Guillaume Kroll

L - 1882 Luksemburg

Tregues i qellimit ekonomik: Shoqeria ka per qellim pjesemarrjen, ne cfaredolloj forme qofte, ne ndermarrjet tregtare, industriale, financiare , apo te tjera, te Luksemburgut apo te huaja, dhe mund ti vij ne ndihme, qofte ne forme huaje, garancie, paradhenie apo menyra te tjera. Per me teper ka si qellim blerjet, me ane te pjesemarrjes, te ndihmes, marrje fikse apo sipas variantit, te bej marreveshje per blerje, me inskriptime apo cfaredolloj tjeter, si dhe tjetersim me shitje, kembime apo ndonje menyre tjeter sipas te drejtes; detyrime, kredite, kartmonedha,leter me vlere dhe licensa dhe te tjera aksione te te gjitha llojeve, zoterimin, administrimin, zhvillimin dhe menazhimin e portofolit te saj. Shoqeria mund te marr hua me te gjitha format dhe te vijoj me nxjerrjen e detyrimeve. Ne nje pamje te pergjithshme, ajo mund te marre te gjitha masat e kontrollit dhe te mbikqyrjes dhe te prishe te gjitha veprimet qe ajo i gjykon te dobishme per permbushjen apo per zhvillimin e qellimit te saj, por gjithmone duke respektuar kufijte e asaj cka eshte shenuar nga ligji i dates 10 gusht 1915 qe ka te beje me shoqerite tregtare.

Kapitali ekonomik / fondet ekonomike:

Shuma: 11.000.000 Euro

Gjendja e shlyerjes: Shlyerje totale

Data e formimit: 25/01/2002

Kohezgjatja:

E pakufizuar

Ushtrimi i aktivitetit ekonomik

Rast i vecante , ushtrimi social i aktivitetit duke qene se ka filluar me date 19/05/2005 do te perfundoj me date 31/12/2005 Nga 01/01 deri me 31/12

Adresa postare: L- 2961 Luxembourg Tel (+352) 26 428 - 1 Faks(+352) 26 42 85 55 www.rcsl.lu
RCSLGL E RCS Luxembourg C 24 Selia dhe Bilateira: Qendra Administrative Pierre Werner 13, Rue Erasme Luxembourg Kirchberg

ADMINISTRATORI (ADMINISTRATORET) DREJTUES ;

Shoqeria merr vendime me anen e firmosjes se dy administratoreve te shoqerise, ose me anen e nje firme e vetme qe perfaqeson te gjithë personat te cilet e kane marre te drejten e kesaj firme nga keshilli i administrates.

Organi : Keshilli i administrates

Mbimri : LOEWEN Emri : Pascale

Funksioni : Administrator

Adresa private ose e punes se personit fizik:

3A, rue G. Kroll, L- 1882 Luksemburg

Kohezgjatja e mandatit: E Percaktuar Data e emerimit: 02/11/2004

Deri ne asamblene e pergjithshme qe do te mbahet ne vitin 2010

E drejta e firmes: - Per te dy

